

## AKT THEMELIMI & STATUT

### I SHOQËRISË TREGTARE

### ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“AmleB Partners” Sh.P.K.

#### NENI 1

##### Formimi

Sot, më datë 12.12.2022, në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, hartohet ky Statut i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“AmleB Partners” sh.p.k.** Themeluese e shoqërisë është Znj.Belma Lleshi, e bija e Belulit, e datëlindjes 09.08.1983, lindur në Tiranë, banuese në adresën Rruga “Fadil Rada”, pallati Vigan, hyrja “C”, kati 1, ap.1/1, me nr. Identifikimi I35809052D, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

#### NENI 2

##### EMËRTIMI, SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ushtrojë veprimtari në bazë të këtij statuti dhe do të emërtohet **“AmleB Partners”** sh.p.k. ajo do të ushtrojë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë në bazë të regjistrimit në institucionet përkatëse si dhe jashtë saj në bazë të modaliteteve ligjore që kërkohen nga shteti ku do të ushtrojë veprimtarinë.

Selia e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara **“AmleB Partners”** sh.p.k është në adresën : Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla 2, kati 7, zyra 15 Tiranë.



### **NENI 3**

### **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**AmleB Partners**” sh.p.k. është për një periudhë pa afat.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kohëzgjatja e aktivitetit mund të zgjatet, të shkurtohet ose të ndërpritet tërësisht ose menjëherë.

### **NENI 4**

Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**AmleB Partners**” sh.p.k. për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit të saj me të tretët përgjigjet vetëm me pasuritë e saj. Ortakët e kësaj shoqërie nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasuritë e tyre që nuk janë futur në kapitalin e kësaj shoqërie. Pjesëmarrja në këtë shoqëri nuk i pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.

### **NENI 5**

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

- Shërbimi e ndërmjetësimit në punësim. Informim për vende të lira të punës. Ndërmjetësim për punësim. Këshillim dhe orientim për punë dhe profesion. Informacion dhe këshillim. Udhëzime për punësim, vlerësim të nevojave, zhvillim të karrierës apo të profesionit metodika për punësim. Pjesëmarrje në përmirësimin e tregut të punës. Shërbime ndërmjetësimi në të dy kahet për punëdhënësin por edhe për punëmarrësin, apo shërbime ndërmjetësimi të pa lidhura ngushtësisht me çështjet e vetëm punësimit etj. Shërbime për punëdhënësin, kryesisht informacion për tregun e punës, shërbime të ofrimit të kandidatëve të mundshëm për rekrutim në punë, informacion për programet e ndryshme të tregut të punës etj.
- Shërbimet e migracionit në fushën e imigrimit atë të emigrimit. Nën këtë përcaktim për “Imigrim”, ofrojmë këshillim ligjor dhe ndërmjetësim në punësim në kuadër të përcaktimeve të ligjit nr.108/2013, datë 28.03.2013 “Për të Huajt”, i cili rregullon regjimin

e hyrjes, të qëndrimit, punësimit, trajtimit dhe të daljes së të huajve nga Republika e Shqipërisë. Referuar vetë subjekteve të mirëpërcaktuar në këtë ligj janë identifikuar të gjithë shtetasit e huaj që synojnë të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kanë si qëllim tranzitim, punësimin, studimin apo ripranimin. Këta të huaj trajtohen në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

- Shoqëria do të japë konsulencë biznesi në fushën e investimeve financiare, ndërmjetësim ligjor për kompani dhe individ që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj.
- Ndërmjetësim të përgjithshëm për kompani dhe individë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.
- Vlerësimi dhe përpilimin e kontratave të kompanive para apo gjatë lidhjes së marrëveshjeve.
- Shoqëria për përbushjen e qëllimit të saj mund të lidhë marrëdhënie nënkontraktuale me persona të tretë.
- **“AmleB Partners”** sh.p.k mund të hapë degë në të gjithë botën, duke patur parasysh legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe të vendit ku do të operojë.
- Shoqëria mund të angazhohet gjithashtu në çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk ndalohet me ligj brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

## NENI 6

Shoqëria mund të ndryshojë emërtim, selinë, objektin e veprimtarisë së saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

## NENI 7 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë **“AmleB Partners”** sh.p.k. është 1.000 (një mijë) lekë.

Pjesëmarja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:

- Znj.Belma Lleshi zotëron 1 (një) kuotë, të barasvlershme me 100 % të kapitalit themeltar. Ky kapital është i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

Kuota e Ortakëve regjistrohet në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

Ai mund të shtohet apo të reduktohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve sipas ligjit 9901, datë 14.04.2022 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”.

Kapitali i shoqërisë i kontribuar nga ortakët do të regjistrohet në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

## **NENI 8**

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar për efekt vlefshmërie duhet të bëhet me akt notarial dhe të regjistrohet si te libri i shoqërisë ashtu edhe tek Zyra e Regjistrit Tregtar.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, jo ortakë, duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

## **NENI 9**

Shoqëria cakton nga fitimet e saj një fond rezervë i cili bëhet në masën 5 % të fitimeve sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Përveç fondit rezervë, shoqëria mund të krijojë edhe fonde të tjera për realizimin e objektivave të saj me miratimin e Asamblesë të Përgjithshme. Shoqëria paguan taksat dhe detyrimet e tjera ligjore përpara Shtetit Shqiptar. Humbjet ose fitimet e mbartura nga viti i kaluar zbriten ose shtohen respektivisht. Mbas aprovimit të llogarive dhe verifikimit të shumës së parave që do të shpërndahet, Asambleja e Ortakëve vendos pjesët që do ti shpërndahen ortakëve.

## **NENI 10**

Shoqëria ka të drejtë të lërë peng një pjesë të kapitalit të saj themeltar. Ne rast shitje të detyruar të pjesëve të lëna peng, pengmarrësi do të pranohet si person të cilin i janë transferuar pjesë të kapitalit, me përjashtim të rastit kur shoqëria preferon ti blejë ato dhe të deklarojë zvogëlimin e mundshëm të kapitalit themeltar.



**NENI 11**  
**STRUKTURA E SHOQËRISË**

Organ i vendimmarrës i shoqërisë do të jetë Asambleja e Përgjithshme. Ajo përbëhet nga ortakët. Asambleja funksionon sipas përcaktimeve të bëra në këtë statut dhe dispozitave ligjore në fuqi.

**NENI 12**

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me ligjin dhe normat e këtij statuti janë të detyrueshme për të gjithë. Ato regjistrohen në librin e shoqërisë.

**NENI 13**

Aktiviteti finansiar i shoqërisë kontrollohet nga ekspertët kontabël të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

**NENI 14**  
**ASAMBLEJA E SHOQËRISË, VENDIMMARRJA**

Në përputhje me nenin 81, pika 3 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2002 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ortakët ushtrojnë të gjitha të drejtat dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme. Të gjithë vendimet e marra nga Ortakët do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve të dhëna e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Në mënyrë të veçantë, duhet të regjistrohen vendimet e mëposhtme për :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Vendime për investime;
- d) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- e) Marrjen përsipër të detyrimeve nga shoqëria për shumat mbi 15.000 euro për çdo veprim ose nëse tejkalojnë shumën totale 15.000 euro në një vit kalendarik.

Çdo vendim i Ortakëve që nuk është regjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm. Ortakët vendosin për të gjitha çështjet e parashikuara në nenin 81 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencë dhe/ose video konferencë, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbal i përkatës.

Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga administratori/et ose ortakët e shoqërisë në përputhje me parashikimet e nenit 84 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe sa herë që thirrja është e detyrueshme sipas ligjit.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë Ime shkrim dhe të firmosen nga Kryetari.

## **NENI 15** **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

Shoqëria do të administrohet nga një administrator me afat 5 vjeçar.

Emri i shoqërisë, administratorit si dhe vula e shoqërisë duhet të figurojnë në të gjitha shkresat zyrtare të shoqërisë si dhe në dokumentat që kanë të bëjnë me përbushjen e objektit, apo që i shërbijnë ushtrimit të aktivitetit të saj.

## **NENI 16**

Administratori përfaqëson shoqerinë në marrëdhënie me të tretët duke zbatuar politikën e drejimit të shoqërisë. Në raste të veçanta mund edhe të caktojë një person tjeter me prokurë të posaçme ose me autorizim.

## **NENI 17**

Administratori mban përgjegjësi për shkelje të ligjit, statutit, rregullores së brendshme para Asamblesë, të tretëve dhe instancave ligjore.



## **NENI 18**

Administrator i shoqërisë është znj.Belma Lleshi.

Administratori ka këto kompetenca:

- përfaqëson shoqerinë në marrëdhënie me të tretët;
- drejton aktivitetin e shoqërisë në bazë të objektit të saj;
- thërret mbledhje të zakonshme;
- harton dhe paraqet raportin vjetor.

Administratori i shoqërisë mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara në emër dhe për llogari të shoqërisë. Në çdo rast, administratori nuk do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve qe ka autorizuar.

## **NENI 19**

Shoqëria nuk merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet apo veprimet juridike të administratorit kur këto nuk i janë përmbajtur objektit të veprimitarës së shoqërisë ose nuk janë në qëllim të përbushjes së objektit.

## **Neni 20**

### **VITI FINANCIAR**

Viti finanziar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundin me 31 Dhjetor. Përjashtimit, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

## **NENI 21**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarës ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetore dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryër një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.



Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar raporton me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**NENI 22**  
**BAZA LIGJORE**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat në fuqi të legjislacionit shqiptar.

**Ortak**  
**E shoqërisë “AmleB Partners” Sh.P.K**

Znj.Belma Lleshi

